



AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË “RB Consulting” SHPK

Sot, më datë 12/12/2025 në Tiranë, Shqipëri, pala e mëposhtme:

- **Z. Giuseppe RUSSO** shtetas Italian, identifikuar me Karten e Identitetit Italiane me numër **CA7529200**, i datëlindjes **09.04.1978** lindur në Sciacca (AG) - ITALI, dhe banues në Via F. Petrarca, N. 25, Caserta (CE) - ITALI.

Shpreh vullnetin e saj për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**RB Consulting**” shpk si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria “**RB Consulting**” sh.p.k, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si Shoqëria, themelohet nw Shqipwri si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

2. Ortakët themelues

Shoqëria është themeluar nga Ortaku i vetwm:

- **Z. Giuseppe RUSSO** shtetas Italian, identifikuar me Karten e Identitetit Italiane me numër **CA7529200**, i datëlindjes **09.04.1978** lindur në Sciacca (AG) - ITALI, dhe banues në Via F. Petrarca, N. 25, Caserta (CE) - ITALI.

3. Objekti i veprimtarisë

Shoqëria “**RB Consulting**” Sh.p.k ka për objekt ushtrimin e këtyre veprimtarive tregtare:

- ofrimin e shërbimeve të konsulencës tregtare dhe organizative për subjekte publike dhe private;
 - shërbime konsulence në fushën e analizës financiare, buxhetimit dhe kontrollit të brendshëm; hartimin e studimeve të fizibilitetit dhe planeve të biznesit;
 - vlerësimin dhe hartimin e studimeve për shitjen ose transferimin e ndërmarrjeve dhe pasurive të paluajtshme;
 - kryerjen e kërkimeve të tregut dhe gjetjen e partnerëve tregtarë;
 - menaxhimin e përkohshëm të ndërmarrjeve; shërbime konsulence në fushën e import-eksportit dhe për fondet e pensione;
-
- organizimin e konferencave, seminareve dhe aktiviteteve promovuese;



- shërbime konsulence lidhur me procedurat e financimit, përfshirë financimet në kuadër të legjislacionit lehtësues rajonal, kombëtar dhe të Bashkimit Europian;
- veprimtari promovuese, realizuese dhe tregtuese, përfshirë edhe për llogari të palëve të treta, të produkteve dhe materialeve për formimin profesional, kërkim dhe zhvillimin e profilit profesional të punonjësve, drejtuesve dhe menaxherëve të bankave, ndërmarrjeve dhe fondeve të pensionit; hartimin dhe zhvillimin e kurseve të trajnimit për menaxhmentin; menaxhimin e agjencive të reklamës, marketingut, marrëdhënieve me publikun dhe komunikimit; promovimin turistik; marrjen përsipër të koncesioneve reklamuese në media të shkruara, radio, televizion dhe kinema;
- ofrimin e shërbimeve të hedhjes së të dhënave (data-entry), arkivimit dixhital, qendrave telefonike (call center) dhe ndihmës teknike (help desk);
- organizimin e kurseve të kualifikimit për personelin e bashkive, qarqeve ose institucioneve të kujdesit shëndetësor;
- organizimin e kurseve të formimit, kualifikimit dhe rikualifikimit profesional në industrinë, tregtinë, bujqësinë dhe turizmin, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, të hapura për të gjithë punonjësit;
- ofrimin e shërbimeve të asistencës, organizimit, programimit dhe menaxhimit në kuadër të konferencave dhe takimeve ndërkombëtare; përkthime simultane, konsektive dhe të betuara në fushën teknike, tregtare, doganore dhe detare, bashkë me procedurat përkatëse;
- shërbime para-konferencës, përfshirë rezervime hotelesh, projektim materialesh, shtypje, përgatitje ftesash, programesh, listave të korrespondencës (mailing list), posterash dhe materialeve promociionale; organizim eventesh, darkash sociale apo pune; mbajtja e marrëdhënieve me publikun, këshillimi dhe komunikimi me personalitete të fushave përkatëse; shoqërimi dhe asistencë e pjesëmarrësve; organizimi i aktiviteteve rekreative; shërbime kongresuale, interpretim dhe përkthim; organizimi i ekspozitave, panairove dhe hapësirave ekspozuese;
- dhënia me qira dhe asistencë për pajisje regjistrimi audio-video; shërbime pas-konferencës; publikimi i teksteve shkencore dhe materialeve didaktike; botimi i akteve të konferencave; vënia në dispozicion e ambienteve për seli të përkohshme të subjekteve për takime ose veprimtari;
- organizimi i kurseve të formimit profesional për përkthyes, pjesëmarrës në konferenca, menaxherë dhe personel të marrëdhënieve me publikun;
- organizimi i kurseve të mësimin në distancë;
- ~~veprimtari botuese jo periodike, përfshirë botimin e librave, materialeve didaktike dhe botimeve online;~~



- shërbime si agjenci promovimi për ofrimin e shërbimeve të energjisë elektrike, gazit, ujësjellësit dhe telefonisë;
- ngritja dhe menaxhimi i zyrove të shtypit, hartimi dhe shpërndarja e deklaratave për shtyp, organizimi i intervistave dhe konferencave për shtyp, si dhe prodhimi i materialeve audiovizive dhe filmike;
- planifikimi dhe blerja e hapësirave reklamuese; kryerja e kërkimeve të tregut;
- komunikimi multimedial, teknologjitë e reja edukative, informimi për didaktikën, kërkimi dhe zhvillimi në fushën e shkencave sociale dhe humane;
- shërbime të krijimit dhe shpërndarjes së reklamave, menaxhimi i grupeve të marketingut; projektimi i markave tregtare dhe patentave;
- formimi dhe përditësimi profesional i operatorëve të sektorit shëndetësor në kuadër të programit të Edukimit të Vazhduar në Mjekësi, si në formë të pranishme, ashtu edhe në distancë;
- formimi dhe trajnimi profesional për operatorët juridikë brenda programit të formimit të vazhdueshëm të Dhomes Kombëtare të Avokatisë;
- formimi profesional i personelit arsimor;
- organizimi i kurseve të trajnimit për sigurinë në vendin e punës, mbikëqyrjen shëndetësore të punonjësve dhe sistemet e vetëkontrollit të ushqimeve (HACCP);
- shitja dhe blerja e produkteve përmes internetit (e-commerce);
- projektimi, zhvillimi, prodhimi, shpërndarja, marketingu, licencimi, instalimi, mirëmbajtja dhe asistenca teknike e programeve kompjuterike (software) dhe komponentëve përkatës në fushën e informatikës, internetit dhe telekomunikacioneve;
- shërbime konsulence lidhur me software-in, përfshirë trajnimin e personelit të brendshëm dhe të tretëve;
- analiza, zhvillimi dhe programimi i software-eve aplikativë; studimi, përpunimi dhe shpërndarja e njohurive teknike ("know-how") dhe instrumenteve operativë informatikë.

Për realizimin e objektit të saj, shoqëria mundet gjithashtu të:

- kryejë veprimtari tregtare, financiare, mobiliare dhe imobiliare, përfshirë marrjen e kredive, financimeve dhe vendosjen e hipotekave;



- ofrojë garanci dhe fidejussione (dorezani / garanci personale), përfshirë garanci reale, edhe në favor të palëve të treta, kur kjo lidhet me interesat e shoqërisë;
- marrë pjesë drejtpërdrejt ose tërthorazi në ndërmarrje, shoqëri, konsorciume ose ente me objekt të ngjashëm, të përafërt ose të lidhur me veprimtarinë e saj.

Shoqëria mund të kryejë edhe çdo veprimtari tjetër të ligjshme që konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për arritjen e objektit të saj, duke përfshirë blerjen, shitjen dhe administrimin e sendeve të luajtshme e të paluajtshme, si dhe pjesëmarrjen në shoqëri apo ndërmarrje të tjera brenda dhe jashtë vendit, si dhe të kryejë çdo lloj aktiviteti të lejuar nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

4. Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë “**RB Consulting**” Sh.p.k do të jetë në Tiranë, në adresën: **Rruga e Barrikadave, Galeria, Ish-kinema 17 Nëntori, Nr. i Pasurisë 7/406-N36, Tiranë, Shqipëri**. Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e Shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

6. Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i Shoqërisë është **100.000 (njëqindmijë) Lekë**. E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të Shoqërisë bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të Shoqërisë në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “**RB Consulting**” Sh.p.k është **Z. Giuseppe RUSSO** shtetas Italian, identifikuar me Kartën e Identitetit Italiane me numër **CA7529200**, i datëlindjes **09.04.1978** lindur në **Sciaccia (AG) - ITALI**, dhe banues në **Via F. Petrarca, N. 25, Caserta (CE) - ITALI**.



Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë 5-vjeçare që nis nga dita e nënshkrimit të këtij Statuti.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “**RB Consulting**” sh.p.k në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES

Z. Giuseppe RUSSO

